

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



“DIGI DIASPORA”, AKTIVITETI I RADHËS NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË

Rrjeti i profesionistëve në Diasporë organizon aktivitetin e radhës në fushën e Teknologjisë. “Digi Diaspora 2” është i organizuar në tre takime në 12 maj, 2 dhe 23 qershor. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është ofrimi i njohurive në fushën e IT-së, përmes angazhimit të diasporës së kualifikuar shqiptare, me synimin e forcimit të kapaciteteve të bizneseve lokale dhe komunitetit digjital, si dhe rrjetëzimit profesional. Aktivitetet do të organizohen online në aplikacionin Zoom, me përfaqësues të suksesshëm të industrisë digjitale të Diasporës.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



AMBASADA SHQIPTARE NË SOFJE NJOFTON RREGULLAT E REJA PËR TË UDHËTUAR NË BULLGARI

Në kuadër të masave anti-COVID Autoritetet shëndetësore bullgare kanë vendosur që hyrja në Bullgari e shtetasve të huaj të jetë e mundur me paraqitjen e dokumenteve si certifikata e vaksinimi, ku përcaktohet marrja e dozave të caktuara dhe kalimi i 14 ditëve nga marrja e dozës së fundit. Vaksinat e pranuar nga pala bullgare janë: Pfizer-Biontech, AstraZeneca AB, SK Bioscience Co Ltd, Moderna, Janssen-Cilag International NV, Serum Institute of India, Sinopharm, Sinovac Biotech Ltd, Sputnik V. Certifikata duhet të përmbajë të dhënat e sakta të personit si në dokumentet e identifikimit, datat e kryerjes së dozave të vaksinave, llojin e vaksinës, emrin e prodhuesit, shtetin e lëshimit dhe institucionin.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



GUVERNATORI SEJKO: PAPANËSIA U RRIËT NË 11.8% POR PROJEKSIONI I EKONOMISË ËSHTË OPTIMIST

Pavarësisht lehtësimit të masave apo edhe vaksinimit që është intensifikuar në javët e fundit, rimëkëmbja ekonomike vijon të mos jetë e plotë. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Z. Gent Sejko deklaroi se vitin e kaluar, shkalla e papunësisë u rrit në 11.8 përqind. Sejko nënvizoi se pasojat ekonomike nga pandemia janë të dukshme, duke shtuar se projeksionet për të ardhmen mbeten pozitive. “Pasojat e pandemisë në ekonomi mbeten të dukshme, në nivelet ende të ulëta të kërkesës agregate, në rënien e punësimit dhe në rritjen e papunësisë. Po ashtu, inflacioni mbetet nën objektivin tonë prej 3%”, vuri në dukje guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

AMBASADA SHQIPTARE NË SOFJE NJOFTON RREGULLAT E REJA PËR TË UDHËTUAR NË BULLGARI



SUEDI/ GATI PASAPORTAT DHE KARTAT ID PËR APLIKIMET DERI NË KËTË DATË



LAZIM DESTANI THIRRJE PËR SOLIDARITET NË LUFTËN NDAJ COVID-19



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.6	105.2
EUR	122.9	123.5
CHF	110.8	111.6
GBP	143.4	144.4
DKK	16 ^{.22}	16.62